



**VENDIM**

**Nr. 53, Datë 29.04.2016**

**MBI**

**LICENSIMIN E SHOQËRISË “LIRIA ENERGJI” SH.P.K., NË  
AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37 pika 2 gërma “ç” dhe 110 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “f”; 5 pika 1, gërma “f” dhe nenit 13 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 29.04.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “LIRIA ENERGJI” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve për liçensimin në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike te kësaj shoqërie,

**Konstatoi se :**

Aplikimi i shoqërisë “LIRIA ENERGJI” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 germat “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të licensojë shoqërinë “LIRIA ENERGJI ” sh.p.k, në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5 -vjeçar.
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s**  
**Petrit AHMETI**